

Pagëzimi

Histori (Mateu 3:11, 13-17; 28:18-20)

Sapo Jezusi filloi të mësonte dhe të shëronte njerëzit, Ai shkoi tek lumi Jordan. Një profet që quhej Gjon ishte aty duke u bërë thirrje njerëzve të ktheheshin nga mëkatet e tyre, sepse Shpëtimtari të cilin e kishin pritur aty shumë, do të vinte së shpejti. Jezusi ishte ky Shpëtimtar!

Jezusi nuk kishte asnjë mëkat për t'u penduar, por Ai donte që të pagëzohej nga Gjon për të na dhënë neve një shembull dhe për të na treguar që Ai ishte dakort me mesazhin e Gjonit.

Në fillim Gjon nuk donte ta pagëzonte Jezusin. Gjon i tha, "Unë kam nevojë të pagëzohem prej teje!." Gjon e dinte që Jezusi ishte më i madh dhe që Ai as nuk ishte i denjë t'i zgjidhte sandalet. E megjithatë, Gjon pranoi ta pagëzonte Jezusin pasi Ai i tha Gjonit që ishte gjëja e duhur për t'u bërë.

Gjon e pagëzoi Jezusin. Jezusi u zhyt krejtësisht nën ujë. Kur Ai doli nga uji, zëri i Perëndisë nga qielli tha, "Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur."

Në fund të shërbesës së Tij në tokë, Jezusi i urdhëroi ndjekësit e Tij të shkojnë dhe të bëjnë dishepuj nga të gjithë popujt e botës dhe t'i pagëzojnë ata në emër të Atit, Birit dhe Frymës së Shenjtë. Gjithashtu, ata duhet edhe t'i mësonin ata t'u bindeshin gjithçkaje që Jezusi u urdhëronte. Dishepujt e Tij bënë ashtu siç Jezusi u tha dhe kudo që shkuan, ata i pagëzuan ata që kishin vendosur të bëheshin ndjekës të Jezusit.

Të gjithë duhen të ushtrohen të ritregojnë historinë, deri sa të arrijnë ta thonë me plot vetëbesim.

Pyetje

1. Çfarë thuhet në këtë histori?
2. Çfarë të mëson për Perëndinë?
3. Çfarë gjëje duhet t'i bindesh?

Vargu përmendësh

Atëherë Pjetri u tha atyre: "Pendohuni dhe secili nga ju le të pagëzohet në emër të Jezu Krishtit për faljen e mëkateve, dhe ju do të merrni dhuratën e Frymës së Shenjtë.

(Veprat e Apostujve 2:38)

Rëndësia dhe kuptimi i pagëzimit

Çfarë është pagëzimi?

Pagëzimi është një simbol/kujtesë për vdekjen, varrosjen dhe ringjalljen e Jezusit (Romakët 6:1-11). Kur ne zhytemi nën ujë, ne kujtojmë që vetja jonë e vjetër (mëkati ynë) është varrosur me Jezusin. Kur ne dalim nga uji, ne kujtojmë që ne jemi ringjallur me Jezusin për një jetë të re.

Pagëzimi është gjithashtu një shenjë e veçantë para Perëndisë dhe të tjerëve që ne e duam Jezusin dhe duam ta ndjekim Atë. Kur njerëzit martohen, shpesh ata vendosin një shenjë për t'u treguar të gjithëve që ata janë të martuar. Çfarë shembujsh ka në kulturën tënde, që tregojnë se njerëzit janë të martuar? Kur ti e ndjek Jezusin, ti duhet t'i tregosh Perëndisë dhe gjithë të tjerëve se sa shumë e do Perëndinë dhe se do që t'i përkasësh vetëm Atij.

Pse të pagëzohesh

- Jezusi u pagëzua. (Mateu 3:13-17)
- Jezusi na urdhëron të veprojmë kështu. (Mateu 28:19; Marku 16:16; Veprat e Apostujve 2:38; 22:16)

Pyetje për pagëzimin

1. E di që Perëndia të ka falur të gjitha mëkatet nëpërmjet sakrificës së Jezusit?
2. A je i vendosur të ndjekësh Jezusin dhe të mos kthehesh kurrë pas?
3. A do të vazhdosh të ndjekësh Jezusin edhe pse mund të të shajnë, të të arrestojnë, të të burgosin apo të të kërcënojnë me vdekje? (A do të vazhdosh të ndjekësh Jezusin edhe pse mund të të duhet të humbasësh punën tënde, të të përzënë nga familja apo të hasësh vështirësi të tjera tipike kur ti i bindesh besimit tënd të ri?)

Përgatitje për pagëzimin

Ti mund të festosh besimin tënd në pagëzimin tënd!

- Kur duhet të jetë pagëzimi?
- Kë duhet të ftojme
- Në pagëzimin tënd ti mund të përgatitesh të tregosh historinë tënde me Perëndinë, për t'ua treguar të gjithëve se si Perëndia të ka shpëtuar dhe ndryshuar.

Cakto sa më shpejt të jetë e mundur kohën kur do të pagëzohesh. Përpunoji pyetjet e pagëzimit dhe jepu përgjigje.